

EAB 4
Juhani Bajrami
M.H. Prof. 23
12/25/01/2019



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KESHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM
Nr 22 Datë 10/01/2019

Per miratimin ne parim per perdorimin të burimit ujore te perroit te Sharres dege lumit Dovjanit ,dege e lumit Devoll,per prodhim hidroenergjie nga subjektit "AVDOLLI" sh.p.k në Bashkia Korce Qarku Korce.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni" te ndryshuare me V.K.M Nr 718 te dates 12/10/2016, Vendimit te Keshillit Kombetar te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujore si dhe Vendimi te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujore" per paisjen me autorizim(miratim ne parim) të subjektit "AVDOLLI" sh.p.k , me propozim të A.B.U. Seman, Këshilli i Basenit Ujor Seman,

VENDOSI:

Mos miratimin ne parim per perdorimin të burimit ujore te perroit te Sharres dege lumit Dovjanit, dege e lumit Devoll,per prodhim hidroenergjie nga subjektit "AVDOLLI" sh.p.k në Bashkia Korce Qarku Korce.

HEC MORAVA

Vepra e marrjes Nr1

X=567336 Y=4490889 Z=1109m

- Prurja mesatare 0.159m³/sek.
- Prurja llogaritese: 0.190 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.012 m³/sek.

Vepra e marrjes Nr2

X=567006 Y=4490975 Z=1109 m

- Prurja mesatare 0.052 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 0.070 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.005 m³/sek.

Godina e centralit

X=565167 Y=4491580 Z=960 m

Mos miratimi pasi keto burime jane te domosdosheme per fyrrnizimin me uje te zones, per vaditje,per pyjet dhe biodiversitetin pasi ndodhen ne zonen turistike te Dardhes.

Ngarkohet ABU Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI ABU SEMAN

Isuf Myrtaj



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KESHILLI KOMBËTAR I UJIT
KRYETARLI KBU SEMAN

